



QËNDRA PËR QEVERISJE TË MIRË



## **RAPORTIMI PERFUNDIMTAR I MONITORIMIT**

Ky raportim u përgatit nga eksperti i MIM i kontratuar nga Qendra për Qeverisje të Mirë (QQM), Tiranë në kuadër të Projektit “LevizAlbania”, në partneriet me tre shoqata me qendër në Kuçovë dhe pikërisht “Gruaja Naftëtare në Fokusin e Zhvillimit”, “ Klubi Rinor Ambientalist Blerimi”, “Ndihmë Sociale Gruas Kryefamiljare” dhe dega Amaro –Drom.

Ky raport është mbështetur nga Lëviz Albania)

### **Të përgjithshme**

Mbetjet urbane, në një pjesë të madhe të territorit të vendit, përbëjnë kërcënim për mjedisin dhe shëndetin e njeriut. Hartimi dhe zbatimi i një sistemi të qëndrueshëm të menaxhimit të mbetjeve, mund të realizohet me sukses vetëm kur institucionet publike të tilla si administrata vendore bashkiake, dhe organe të dekoncentruara si ajo e arsimit, shëndetësisë, mjedisit, apo grupe të shoqërisë civile, qendrat tregtare dhe industriale dhe institucione të tjera të përfshira në këtë proces, janë të vetëdijshëm për përgjegjësitë e tyre dhe kanë vullnetin dhe mjetet e duhura për t'i përmbushur ato.

Në bashkinë Kuçovë shërbimi i grumbullimit transportimit dhe përpunimit në vend-depozitim kryhet me sipërmarrje nga Shoqëria “Higjena” sh.p.k me administrator Z. Vasillaq Golemi, fitues i tenderit të zhvilluar më datë 30.05.2011, me një afat kohor 5 vjeçar. Midis bashkisë dhe shoqërisë sipërmarrëse "Higjiena" shpk Kuçovë është lidhur edhe një kontratë shtesë me afat 1 vit e cila përfundon në datën 27.06.2017. Buxheti i shërbimit të pastrimit për këtë afat kohor është vendosur në shumën 32,009,320 lekë (afërsisht 50% më shumë se më parë) edhe pse harta e re territoriale e bashkisë aktuale përfshin sipërfaqe shumë më të madhe shërbimi dhe numër më të madh familjesh.

Sfida kryesore për bashkinë e re të Kuçovës mbetet ofrimi i shërbimit të menaxhimit të integruar të mbetjeve në një territor më të madh se 3 vite më parë, i cili detyrimisht kërkon në radhë të parë hartimin e një strategjie shërbimi të ndryshme nga ajo e mëparshme dhe e shoqëruar me ndryshimin e standarteve përkatëse.

Problematikat më shqetësuese të identifikuar, me të cilat po përballen bashkia janë përmirësimi i infrastrukturës rrugore në të gjithë territorin dhe sidomos me vëmendje të veçantë në zhvillimin e infrastrukturës ndërlidhëse të fshatrave të ish-komunave me qendrën kryesore administrative, bashkinë Kuçovë.

Mbetjet urbane në bashkinë Kuçovë grumbullohen në mënyrë tradicionale të pandara dhe transportohen në fushën e depozitimit të mbetjeve e cila ndodhet në buzë të lumit Devoll, në kushte jo të mira teknologjike. Situata në të cilën ato gjenden, krijon rrezik të dukshëm për jetën e individëve brenda dhe përtej territorit të bashkisë Kuçovë. Përpunimi i materialeve të hedhura dhe të mbledhura për riciklimin bëhet kryesisht në fushën e depozitimit nga njerëz në nevojë dhe të pa autorizuar.

Në 2014 në bashkinë Kuçovë është realizuar studimi i fizibilitetit për ndarjen në burim të mbeturinave urbane, me synim ripërdorimin dhe riciklimin e tyre. Bashkia Kuçovë u përzgjedh për këtë nga projekti Assist IMPACT/USAID, përmes kontraktimit të ARZH Fier dhe aktorëve të tjerë si Co-Plan dhe URI. Në dokumentin e politikave të zhvillimit të territorit të bashkisë Kuçovë, përgatitur nga Bashkia Kuçovë me mbështetjen teknike të projektit PLGP të Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar dhe Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit, citohet se “Në shkarkimet ujore vihet re një prani e lartë të klorureve, fenoleve dhe naftës bruto që derdhen nëpër kolektorin kryesor të ujrave të zeza apo kanaleve të tjera dhe përfundojnë në lumin Devoll dhe Osum. Niveli i fenoleve në shkarkim të lumin Devoll arrin në 2mg/l, i klorureve 20.000- 50.000 mg/l, ndërsa niveli i naftës bruto në 40-90 mg/l”. Në konkluzionet e këtij materiali theksohet se “Duhet që mbetjet të diferencohen patjetër që në burim, në mënyrë që të ketë një nivel më të lartë riciklimi. Vend-depozitimi që ndodhet në Rreth-Tapi, pranë shtratit të lumit Devoll duhet të mbyllet sipas standardeve përkatëse dhe të transferohet, si landfill sanitar-inxhinierik, në një vend tjetër në një territor gjeologjikisht dhe teknikisht të përshtatshëm, larg akuifereve dhe me përshkueshmëri të ulët”.

Pas miratimit të territorit të ri të bashkisë, për shërbimin e grumbullimit të mbetjeve është vendosur të ofrohet në të gjithë territorin e bashkisë dhe ky është një tregues pozitiv. Prioritet duhet të jetë diferencimi i mbetjeve urbane, për të patur një ndotje sa më të ulët në territorin e kësaj bashkie”.

### **Kuadri ligjor bazë**

Veprimtaria e bashkisë për të realizuar këtë shërbim bazohet në tre ligje bazë me ndikim të madh në veprimtarinë e bashkive, të cilët dispijlojnë mbrojtjen e mjedisit, ruajnë dhe përmirësojnë gjëndjen e tij si dhe parandalojnë dhe pakësojnë rreziqet ndaj jetës e shëndetit të njeriut në nivel vendor. Këto tre ligje janë:

1. ligji për mbrojtjen e mjedisit (2011), i cili u kërkon njërive vendore të përgatisin plane veprimi, vendore, për mjedisin në mënyrë periodike.
2. ligji për planifikimin dhe zhvillimin e territorit (2014) i cili synon të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm të territorit, nëpërmjet mbrojtjes dhe përdorimit racional të tokës dhe të burimeve natyrore si ajri, uji, pyjet, flora, fauna, peizazhet;
3. ligji për vetqeverisjen vendore (2015) i cili përcakton kryerjen e tre funksioneve të mëposhtme:
  - sigurimin e masave për mbrojtjen e cilësisë së ajrit, tokës dhe ujit nga ndotja.

- sigurimin në nivel vendor të masave për mbrojtjen nga ndotja akustike.
- zhvillimin e aktiviteteve edukuese dhe promovuese të cilat lidhen me mbrojtjen e mjedisit.

Në bashkinë Kuçovë, shumica e mbetjeve nuk trajtohen në vendin e depozitimit në landfille të ndërtuara sipas standarteve bashkëkohore. Mbetjet, duke përjashtuar ato të ngurtat, transportohen në një territor të caktuar vite më parë nga bashkia, afër bregut të lumit që quhet vend-grumbullim. Këtu nuk bëhet fjalë vetëm për mbetjet organike, që përbëjnë pak më shumë se gjysmën e mbetjeve totale, por edhe për një pjesë të mirë të materialeve që mund të riciklohen.

Bashkia përballlet në vazhdim me sfidën e zbatimit i ligjit të ri të vetqeverisjes vendore dhe funksioneve të reja të transferuara drejt tyre, ku shërbimi i heqjes, transportimit dhe grumbullimit të mbetjeve në bashkinë Kuçovë paraqitet si funksion tepër i brishtë në aspektin mjedisor. Aktualisht në bashki nuk ka plan vendor të mbrojtjes së mjedisit. Kohët e fundit bashkia Kuçovë dhe institucioni i qarkut Berat, janë të angazhuara në një projekt të përbashkët me mbështetje të qeverisë Zviceriane, me synim hartimin e një “plan veprimi” për menaxhimin e integruar të mbetjeve urbane në nivel qarku.

Në faqen web të bashkisë Kuçovë, citohet se një nga objektivat për të ardhmen është **“Të shuhen diferencat në zhvillim, në shërbime e infrastrukturë** midis zonave më të largëta e më të varfëra të bashkisë dhe qendrës së saj”.

Grumbullimi, transportimi dhe përpunimi i mbetjeve në vend-depozitim bazohet në ligje të hartuara posaçërisht për këtë shërbim dhe ligje sektoriale sidomos ato të ndikimit në mjedis. Baza e veprimtarisë së Bashkive mbështetet kryesisht në ligjet e mëposhtme:

- Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”
- Ligji nr. 9537, datë. 18.5.2006 “Për menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme”.
- Ligji nr. 10463 dt.22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”
- Ligji nr. 10431, datë 09.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”
- Ligji nr. 10440, datë 7.7.2011, "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis"
- Ligji Nr. 107/2014 datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”.
- VKM Nr 418 datë 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”.
- VKM, nr.687, datë 29.07.2015 “ Për mitatimin e rregullave për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve”.
- VKM, nr.575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”.
- VKM, nr.229, datë 23.04.2014 “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme”
- Vendimi nr. 99, datë. 18.02.2005 “Mbi miratimin e Katalogut Shqiptar për klasifikimin e mbetjeve”

- Norma nr.1, datë 30/3/ 2007 “Mbi trajtimin e mbetjeve të ndërtimeve e të shkatërrimeve nga krijimi, transporti deri tek trajtimi përfundimtar”
- Norma nr. 6, datë 30.11.2007 “Mbi menaxhimin e mbetjeve spitalore”
- Udhëzues nr. 6, datë 27.11.2007 “Mbi aprovimin e rregullave, përmbajtjes dhe afateve për skicimin e planeve të menaxhimit të mbetjeve të ngurta”

### **Të dhëna të përgjithshme mbi bashkinë Kuçovë**

Kuçova është një qytet në Shqipërinë e Mesme rreth 85 km larg nga Tirana dhe përfshihet në qarkun e Beratit me qytetin e Kuçovës si qendër administrative kryesore. Qyteti i Kuçovës konsiderohet si qytet industrial për shkak të burimeve natyrore të naftës dhe gazit, rreth të cilave në vitet pas 1950-të u krijua aktiviteti i madh prodhues. Nafta dhe gazi natyror mbeten burimet kryesore të bashkisë Kuçovë, edhe pse ato kanë mbetur të pashfrytëzuara ose të shrytëzohen në mënyrë të pjesshme. Sipërfaqja e kësaj bashkie është 160.23 km katrorë me një popullsi rreth 55.000 banorë. Kryetar i bashkisë është Z. Selfo Kapllani dhe numri i anëtarëve të këshillit bashkiak është 31. Njësitë administrative të përfashira në këtë territor janë qyteti Kuçovë dhe ish komunat Kozarë, Perondi dhe Lumas.



Banoret e Kuçovës flasin dialektin tosk, pa ndryshime të dukshme më të folurën letrare shqipe, veshja është ajo e tipit të Myzeqesë.

Nga veriu bashkia Kuçovë kufizohet me bashkinë e Belshit, nga verilindja kufizohet me bashkinë Cërrik, nga veriperëndimi dhe perëndimi kufizohet me bashkinë Lushnje, nga jugu dhe jugperëndimi kufizohet me bashkinë Berat, nga jugu dhe juglindja kufizohet me bashkinë Çorovodë, nga lindja kufizohet me bashkinë Gramsh.

Prej sipërfaqes totale prej 160,2 km<sup>2</sup> që bashkia Kuçovë aktualisht zotëron, toka natyrore përbën 58,46 km<sup>2</sup> ose rreth 36,49% të sipërfaqes totale, toka bujqësore përbën 83,51 km<sup>2</sup> ose rreth 52,12%, sipërfaqja ujore përbën 4,65 km<sup>2</sup> ose rreth 2,9%, toka urbane përbën 8,67 km<sup>2</sup> ose rreth 5,41% dhe toka për infrastrukturën përbën 4,92 km<sup>2</sup> ose rreth 3%. Klima e territorit të bashkisë i Kuçovë është mesdhetare me dimër të butë e me lagështirë, dhe me verë të nxehtë e të thatë. Temperaturat mesatare arrijnë në 16.17° me reshje mesatare vjetore 137.67 mm. me lagështi relative në orë 70-73 % dhe drejtim të erërave Jug – Lindje dhe Jug – Perëndim. Grafiku i mëposhtëm paraqet popullsinë sipas ndarjes së re administrative sipas ndarjes prej reformës 2014.

Nr	Njësia administrave	Nr. banorëve	Nr.familjeve
1	Qyteti Kuçovë	30,017	7,040
2	Komuna Kozarë	8,369	2,118
3	Komuna Lumas	7,045	2,054
4	Komuna Perondi	11.008	2,685
5	Bashkia Kuçovë	56,150	13,897

### **Plani i veprimit për menaxhimin e integruar të mbetjeve urbane në bashki**

Në vitin 2004 bashkia Kuçovë hartoi dhe miratoi për herë të parë “standardin e shërbimit të pastrimit”, dhe në vitin 2009, duke patur parasysh eksperiencën e krijuar në pesë vite, ky standard u përmirësua. Në vitin 2011, në bashkëpunim me Shoqatën e Bashkive të Shqipërisë (SHBSH), u bë i mundur botimi i një “manuali” për “standardin e shërbimeve publike” me përqëndrim tek shërbimi i pastrimit për bashkitë e mesme dhe të mëdha të vendit tonë.

Bashkia Kuçovë, në bashkëpunim me Qendrën Mjedisore “EDEN” Tiranë, në Korrik – Gusht të vitit 2013, hartoi një “plan veprimi” për menaxhimin e integruar të mbetjeve urbane në bashki, me financim të Ambasadës së SHBA.

Hartimi i këtij “plan veprimi” si dokument planifikues i menaxhimit të mbetjeve, pati disa qëllime në vetvete. Ky plan vlerësohet se është:

- mjet komunikimi ndërmjet bashkisë dhe qytetarëve, që parashtron problemet në fushën e menaxhimit të mbetjeve urbane, duke shpjeguar ndryshimet që duhen bërë dhe duke përcaktuar prioritetet e veprimit.

- instrument për të orientuar ndërgjegjësimin qytetar në drejtim të sjelljeve të bashkisë përkundrejt ambienteve të përbashkëta.
- orientim të sjelljeve tona përkundrejt detyrimeve tona.

Plani përmban dy elementë me shumë peshë për të ardhmen si në vijim:

- përcaktimin e kostove dhe të mënyrës më të pranuar për menaxhimin e mbetjeve
- edukimi mjedisor dhe ndërgjegjësimi qytetar.

Plani analizon situatën aktuale të menaxhimit të mbetjeve urbane në qytetin e Kuçovës duke përfshirë organizimin, administrimin, rregulloret, financat, si edhe identifikon çështjet e mangësitë, vlerëson pikat e forta dhe të dobëta, propozon rekomandime për përmirësime dhe përcakton vizionin, qëllimin dhe objektivat e reja (afatshkurtëra, afatmesme dhe afatgjata). Në këtë “plan veprimi” përcaktohen afatet kohore, kostot, autoritetet përgjegjëse si edhe indikatorët respektivë të suksesit për qëllime monitorimi.

#### **Plani vendor i menaxhimit të integruar të mbetjeve**


Plani i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve ka mundësuar orientimin strategjik të Bashkisë Kuçovë drejt një menaxhimi të qëndrueshëm të mbetjeve. Plani ka krijuar hapësirën dhe mundësinë për:

- përputhshmëri me Strategjinë Kombëtare të Mbetjeve (SKM) dhe objektivat e saj.
- përputhshmëri me planin rajonal të MIM dhe objektivat e tij.
- ndërtimin dhe krahasimin e skenarëve të ndryshme për MIM.

- identifikimin dhe rekomandimin e teknologjive përkatëse për minimizimin dhe asgjësimin final të mbetjeve;
- rekomandime për hartimin e instrumentave të rëndësishëm institucionale, organizativë dhe rregullatorë, bashkë me masat për përmirësimin e elementeve përbërës të tij;
- parashikime për nevojat financiare për investime për zbatimin e skemave të grumbullimit, transportimit dhe trajtimit të mbetjeve.

Plani përmban këto çështje kryesore:

- miratimin brenda kornizave që ka lejuar koha, buxheti si dhe angazhimi i qarkut .
- procedurat dhe personat përgjegjës për kontrollin e menaxhimit të mbetjeve urbane;
- insiativat për evidentim të sasisë dhe cilësisë së mbetjeve të gjeneruara në fushë-depozitë;



- bashkërendim të punës ndërmjet bashkisë dhe institucioneve të tjera të linjës (si ARM) për të kontrolluar dhe monitoruar situatat alarmante në Bashki.
- nismat për fillimin e ndarjes në burim të mbetjeve duke përfshirë edhe komunitetin;
- rishikimin e tarifës në bazë të parimit ndotësi paguan;
- mënyrat alternative për mbledhjen e taksës së pastrimit;
- bashkëpunimin me biznesin për edukimin dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve përmes TV lokale, edukimit në punë, shkollë etj...
- transparencën ndaj komunitetit për tarifën e pastrimit si për familjet dhe për bizneset;
- pilotimin e mundshëm për një pjesë të caktuar të bashkisë për t'i nxitur qytetarët për ndarjen e mbetjeve në burim.

Në kontratën me firmën sipërmarrëse janë përcaktuar zërat e punës që duhet të kryhen dhe konkretisht:

- fshirja e rrugëve me krahë, spërkatja dhe larja e tyre;
- fshirja e rrugëve me makineri teknologjike;
- heqja e transportimi i mbetjeve urbane dhe ato voluminoze;
- trajtimi i mbetjeve në vend-grumbullim me ditë të caktuara.

Ky sektor ka hasur vështirësitë e mëposhtme:

- përcaktimin e kufijve administrativë të zonave të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve;
- përcaktimin e autoritetit të ofrimit të shërbimit në kufi midis njësive administrative, si p.sh në Lumas;
- grumbullimin e informacionit mbi prodhuesit e mbetjeve që kalojnë kufijtë e një bashkie: bashkia Kuçovë ka siguruar të dhëna të vlefshme se cila palë duhet t'i menaxhojë ato;
- grumbullimin e informacionit shtesë mbi familjet brënda territorit duke specifikuar banorët që jetojnë informalisht në zonat pranë kufijve të qytetit;

Këshilli Bashkiak ka kryer miratime të arsyetueshme të akteve rregullatore në drejtim të menaxhimit të mbetjeve. Titullari i bashkisë ka qënë i sukseshëm pasi ka punuar me kujdes për të gjetur mbështetje dhe mirëkuptim me Këshillin Bashkiak.

#### **Të dhënat bazë mbi sasinë e mbetjeve nga sektorë të ndryshëm të biznesit.**

Lloji	Përbërja	% ndaj totalit	Sasia e mbetjeve të vlerësuara 2014 (ton)
74 %	<b>Organike</b>	<b>48%</b>	<b>11</b>

Të pariciklueshme	<b>Të tjera</b>	<b>26%</b>	<b>6</b>
26 %	<b>Letër dhe karton</b>	<b>12%</b>	<b>2.7</b>
Të riciklueshme	<b>Plastikë</b>	<b>9%</b>	<b>2</b>
	<b>Qelq</b>	<b>2%</b>	<b>0.5</b>
	<b>Metale</b>	<b>2%</b>	<b>0.5</b>
	<b>Totali</b>	<b>100%</b>	<b>22.7</b>

Nr	Kategoria e konsumatorit	% kundrejt totalit	Sasia e vlerësuar e mbetjeve të prodhuara (ton)
1	<b>Njësi të biznesit të vogël</b>	<b>20%</b>	<b>4.5</b>
2	<b>Njësi të biznesit të madh</b>	<b>15%</b>	<b>3.3</b>
3	<b>Ndërmarrje &amp; Institucione</b>	<b>10%</b>	<b>2.3</b>
4	<b>Familje</b>	<b>55%</b>	<b>12.5</b>
	<b>Totali</b>	<b>100%</b>	<b>22.7</b>



## **METODOLOGJIA E PËRDORUR PËR VËZHGIMIN E MBETJEVE NË TERREN**

### 1)-Të dhëna përgjithshme

Qendra për Qeverisje të Mirë në projektin e mbështetur prej “LëvizAlbania” me titull “Monitorim i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve (MIM), instrument për nxitje dhe reflektim të qëndrueshëm të qytetarëve të Bashkisë Kuçovë”, ndërmjet aktiviteteve të tjera përshtu edhe metodologjinë e vëzhgimit në terren të menaxhimit të mbetjeve.

Kjo pjesë e projektit pati këtë përmbajtje:

- Fazat kryesore të procesit të vëzhgimit ( dmth aktivitetet parapërgatitore, punën në terren, analizat e gjetjeve, prodhimin e draft-raportit, shfrytëzimin e të gjithë burimeve të informacionit që u përftua, shkrimin e raportimit dhe finalizimin e raportimit.
- Mënyrën se si vëzhguesit u zgjodhën dhe u përfshinë në procesin e vëzhgimit, duke targetuar grupet specifike ( si psh gratë,, rininë romët ambientalistët,biznesin, familjet me të ardhura të pakta apo personat me aftësi të kufizuara etj....
- Vëndin apo vëndet ku u krye vëzhgimi dhe dhe zgjatjen në kohë e procesit të verifikimit të shërbimit të mbetjeve në bashki.
- Instrumentat që u përdorën për të mbledhur informacion me të dhëna dhe pamje nëpërmjet vëzhgimit dhe fotografikimit direkt në terren,
- Mënyrën se si u mblodhën, rregjistruan dhe analizuan të dhënat e dala prej vëzhgimit në terren dhe nga faktet e përfuara.
- Kohën se kur u hartuan draft raportit dhe raportimi përfundimtar.

Ekspertiza kërkoi:

- Përfaqse apo cilësi të cilat specifikohen për të gjithë ekipin e verifikuesve,
- Përbërjen dhe strukturën dhe njohuritë e grupit vëzhgues të tilla si shkollimi, njohja e problematikës që u vëzhgua, eksperincat e mëparshme në këtë fushë apo eksperiencia të ngjashme.
- Përzgjedhjen dhe caktimin i drejtuesit të grupit në bazë të disa kritereve të paracaktuara dhe marrdhëniet me anëtarët e tjerë të grupit vëzhgues.
- Përcaktimin për sejcilin pjesëtar të grupit, i detyrave të përbashkëta dhe të veçanta.
- Shpërndarjen e informacionit në të gjithë ekipin mbi mënyrën e punës, planin e aktiviteteve, kohën që kërkohet për kryerjen e verifikimit.
- Vendosjen e mjeteve të komunikimit dhe të bashkëpunimit me njeri tjetrin dhe mënyrën e buxhetimit të aktivitetit.

Në kërkesat për raportim të saktë u përfshinë:

- Përbajtja kryesore që ka lidhje të ngushtë me qëllimin e vëzhgimit së bashku me anekset e mundshme.
- Raportimi në kohën e paracaktuar:

- Saktësia e të shprehurit në shkrimin e raportimit, bazuar në drejtshkrimin e gjuhës shqipe.
- Madhësia e gërmave që duhej të përdorej , e njëjtë për të gjithë vëzhguesit.
- Formatin kompjuterik të raportimit të njëjtë për të gjithë vëzhguesit.
- Dorëzimi i raportimit në kohën e përcaktuar në projekt.
- Dorëzimi i raportimeve tek personi përgjegjës i njohur më parë si i tillë.
- Numrin e kopjeve në të cilën u dorëzua raportimi.
- Formatin e raportimit në letër dhe në postim elektronik.

## 2)-Qëllimi i përdorimit të kësaj metodologjie ishte:

- për të vlerësuar gjëndjen në terren të kryerjes së shërbimit të heqjes, transportimit dhe trajtimit të mbetjeve në vend grumbullim.
- për të vlerësuar dhe krahasuar raportimin prej vëzhgimit në terren me të dhënat e marra prej bashkisë si edhe me të dhënat e dala nga anketimi i qytetarëve në ndihmë të finalizimit të raportit përfundimtar.
- për të rritur pjesëmarrjen e grupeve të shoqërisë civile dhe të qytetarëve në qeverisjen vendore në shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në bashkinë Kuçovë
- për të rritur besimin e palëve të përhira në process për përmirësimin e shërbimit të heqjes , transportimit dhe trajtimit të mbetjeve në vend grumbullim.

## 3)-Metodologjia përfshiu këto faza kryesore të procesit si më poshtë:

- aktivitetet parapërgatitore,
- vëzhgimin në terren,
- analizën dhe sitemimin e të dhënave prej vëzhgimit,
- prodhimin e një draft-raportimi mbi vëzhgimet e kryera,
- shkrimin i raportimit përfundimtar.

Drejtori ekzekutiv i QQM si edhe ekspertët për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve (MIM dhe eksperti i Vëzhgimit në Terren (VT) si edhe shoqata partnere në Kuçovë, realizuan disa takime ku përcaktuan detyrat e palëve për këtë pjesë të projektit.

Shoqata partnere në Kuçovë u bënë struktura kryesore për njoftimin për rekrutimin e vëzhguesve. Pas një afati të caktuar kohor të njoftimit,(jo më shumë se dhjetë ditë) u listuan emrat e personave që aplikuan, për të vazhduar më tej me procesin e përzgjedhjes së personave që kryen vëzhgimin në terren .

Vëzhguesit që aplikuan u zgjodhën nëpërmjet një selektimi mbi bazë të një formati të caktuar për individë me cilësi të veçanta.

Stafi i QQM qartësoi procedurat e njoftimit dhe të rekrutimit të personave që kryen vëzhgimin. Me marrëveshje organizatat partnere u dakordësuan për procesin e rekrutimit të vëzhguesve dhe ndanë detyrat e përgjegjësitë midis tyre.

QQM , nëpërmjet drejtorit të saj, Eksperti i MIM , dhe eksperti i VT dhe organizatat partnere në Kuçovë mundësuan përzgjedhjen e personave më të përshtatshëm dhe krijimin e 8 grupeve të verifikimit në terren.

Përzgjedhja e individëve u realizua duke u mbështetur në njohuritë mbi objektin e punës, cilësitë dhe motivimin përkatës që kishin vëzhguesit e përcaktuar si më poshtë.

#### 4)-Objekti i punës së vëzhguesve:

- vëzhgon veprime të thjeshta, të dukshme të kryerjes së shërbimit të mbetjeve në bashki.
- vëzhgon një ose shumë çështje si shqetësim për komunitetin e bashkisë Kuçovë.
- vëzhgon me fokus interesin dhe mirëqenien e komunitetit.
- vëzhgon veprimtarinë e strukturave që ofrojnë shërbimin për të mos shkaktuar dëm ndaj interesit publik.
- paraqet pamje dhe praktika negative të përshkruara apo të fotografuara.
- mban shënime të kujdesshme në çdo vëzhgim,
- raporton mbi vëzhgimin e kryer

#### 5)-Cilësitë dhe motivimi për të kryer një veprimtari të tillë,

U pranuan vëzhgues me:

- aftësi shumë të mirë komunikuese dhe kohë të mjaftueshme për të kryer punën,
- aftësi për të zgjedhur vëndin për të qëndruar dhe për të marrë me saktësi informacionin,
- durim për të kryer aktivitet me kohë të gjatë dhe të mund të përballojë presionin nga jashtë.
- aftësi të dalë përtej pozicionit politik dhe të qëndrojë me vendosmëri përballë vështirësive.
- aftësi të punojë në grup dhe të bashkëpunojë me individë e struktura të tjera të përfshira në process
- njohuri mbi përmbajtjen e shërbimit të mbetjeve dhe të palëve të të përshira.
- motivim për interes personal për të mirën kolektive ( të gjithë taksapagues të shërbimit)
- dëshirë për të shuar fuqinë e prezencës së pjesmarrjes qytetare në shërbimin e menaxhimit të mbetjeve.
- qartësi se veprimtaria e tij parandalon kostot e tepërta.
- vetëdije se aktiviteti i tij promovon barazi për jetë më të mire komunitare.
- besimin se puna e tij promovon dhënien e informacionit si bazë e qytetarisë dhe jetës komunitare

Përzgjedhja u realizua sipas disa kërkesave të vendosura në formate si më posht

### CV e kandidatit për verifikues në terren

1	Emri Mbiemri	
2	Datëlindja	
3	Adresa	
4	Tel (fiks; celular)	
5	Seksi	
6	Niveli arsimor	
7	Statusi social	
8	Eksperienca në punë	
9	Aftësi personale	

#### Elementët e rëndësishëm të përzgjedhjes :

1-Personat që ishin të gashëm dhe marrin përsipër për të kryer veprimtari verifikuese mbi mbetjet pavarësisht nga mosha , gjinia, seksi i tyre.

2-Personat që kishin njohuri dhe janë të vetëdijshëm për veprimtarinë që do të kryejnë.

3-Personat që kishin kryer veprimtari të ngjashme si kjo, si vlerë e shtuar për përzgjedhjene tyre.

Formulari i përzgjedhjes si më poshtë:

Elementi faktorizues	Rëndësia në përqindje %
Eksperienca në këtë fushë	

Aftësitë komunikuese	
Motivimi	
Rekomandimet	
Kualifikimet e ngjashme	
Mosha	
Objektiviteti i personit	
Këmbëngulja për të realizuar detyrën	
Aftësia për të nxjerrë produkt të saktë e të plotë	
Aftësia për raportim të saktë	

Vëzhguesit e zgjedhur u trajnuan për mënyrën e përfshirjes në procesin e vëzhgimit, duke u ofruar atyre njohuri mbi kontratën e nënshkruar midis kompanisë sipërmarrëse dhe bashkisë Kuçovë .

Trajnimi përmbante gjithashtu njohuri dhe të dhëna mbi:

- vëndin apo vëndet e vëzhgimit dhe zgjatjen në kohë e procesit të verifikimit të shërbimit të mbetjeve në bashki.
- instrumentat që u përdorën për të mbledhur informacion me të dhëna dhe pamje të përfuara nëpërmjet vëzhgimit direkt në terren,
- mënyrën e mbledhjes, regjistrimit dhe analizimit të të dhënave të dala prej vëzhgimit në terren dhe nga faktet e përfuara.
- kohën se kur duhej hartuar draft raporti dhe raportimi përfundimtar.

Pajisja me ekspertizën përkatëse u fokusua mbi:

- asetet, aktivitetet, pajisjet apo cilësi të cilat u specifikuan për të gjithë ekipin e verifikuesve.
- Përbërjen, strukturën dhe njohuritë e individëve pjestarë të grupit vëzhgues të tilla si shkollimi, njohja e problematikës që duhej vëzhguar, eksperiencat e mëparshme në këtë fushë apo eksperiencia të ngjashme.
- përzgjedhjen dhe caktimin i drejtuesit të grupit në bazë të disa kritereve të paracaktuara dhe marrdhëniet me anëtarët e tjerë të grupit vëzhgues.
- Përcaktimin, për secilin pjesëtar të grupit, e detyrave të veçanta.
- shpërndarjen e informacionit në të gjithë ekipin mbi mënyrën e punës, planin e aktiviteteve, kohën që kërkohet të kryhet verifikimi etj....,
- vendosjen e mjeteve komunikuese dhe të bashkëpunimit me njeri tjetrin dhe mënyrën e buxhetimit të aktivitetit.

Kërkesat për raportim të saktë u fokusuan në:

- përbajtjen kryesore në lidhje të ngushtë me qëllimin e vëzhgimit së bashku me anekset e mundshme.
- raportimin në kohën e paracaktuar.
- saktësinë e të shprehurit në shkrimin e raportimit, bazuar në drejtshkrimin e gjuhës shqipe.
- madhësinë e gërmeve që duhej të përdorej , e njëjtë për të gjithë vëzhguesit.
- formatin kompjuterik të raportimit të njëjtë për të gjithë vëzhguesit.
- dorëzimin e raportimit në kohën e përcaktuar në projekt.
- dorëzimin e raportimeve tek personi përgjegjës i njohur më parë si i tillë.
- numrin e kopjeve në të cilën duhej të dorëzohej raporti.
- formatin e raportimit në letër dhe në postim elektronik.

Ekspteri i MIM dhe ekspert i VT ofruan 3 formate të posaçme për vlerësimin dhe plotësimin me shkrim të veprimtarisë vëzhguese në terren. Këto formate janë si më poshtë:

### **1.Vëzhgim i aseteve**

Vlerësimi në vend gjëndjes teknike të aseteve që përdoren për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve.

Lloji i asetit	Papërdorshëm	Kërkon shumë përmirësime	I mirë; mund të përmirësohet	Shumë i mirë	Përshkrime dhe komente të shoqëruara me fotografime
Makinë teknologjike					
Kontenierë					
Transportues të vegjël					
Transportues të mëdhenj					
Transportues të hapur					

Transportues të mbyllur					
Kosha të vegjël në trotuare					
Traktorë					
Vinça					
Mjete e pajisje ndihmëse, mjete pune etj...					

## **2.Vëzhgim i proceseve**

Vëzhgimi i procedurave që përdoren për mbledhjen , transportimin dhe përpunimin në vendgrumbullim të mbetjeve.

Procedurat	Jo e mirë apo/ose e pakët	Duhet shumë përmirësim	E mirë por /ose e pakët . Të përmirësohet	Sh.mirë	Përshkrime dhe Komente të shoqëruara me Fotografime
Koha reale e nisjes së grumbullimit të mbetjeve.					
Koha e zbrazjes së tyre në landfill.					
Koha e kthimit mbrapsht në vendparkim.					
Sasia e fshirjeve dhe larjeve ditore.					

Pajisja me kod e kamionit dhe kontenierëve.					
Riparimet e kontenierëve me problem.					
Sasia itinerareve dhe e orëve të punës së kamionëve.					
Përputhja në orare e makinave dhe pajisjeve.					
Përpunimi i mbetjeve në vëndin e depozitimit.					
Djegia në ambjent të hapur.					
Ndotja mjedisore në tokë apo në ajër.					
Mbulimi me shërbim i territorit					
Zbrazja dhe sistemimi përreth kontenierve					
Pastrimi dhe dizinfektimi rretheqark konteniervë					



Shmangia e humbjeve, derdhjeve apo rrjedhjeve.					
Sasia e mbetjeve të pagrumbulluara në fund të procesit ditor.					
Sasia e mbetjeve për kompostim.					

### **3.Vëzhgim i punonjësve**

Vëzhgimi i punonjësve në mbledhjen , transportimin dhe përpunimin në vendgrumbullim të mbetjeve.

Procedurat	Jo e mirë apo/ose e pakët	Kërkon shumë përmirësim	E mirë por apo/ose e pakët . Të përmirësohet	Sh.mirë	Përshkrime dhe Komente të shoqëruara me Fotografime
Marrja dhe qëndrimi në punë sipas aftësive të kandidatëve.					
Njohja dhe përdorimi i mjeteve dhe pajisjeve.					
Zbatimi i rregulloreve të përcaktuara.					
Përgjegjësia dhe detyra të					

ndara.					
Njohja me përshkrimin e qartë i punës që duhet të kryhet .					
Njohja dhe zotërimi i proceseve të punës.					
Zbatimi i grafikëve të punës me oraret apo me shërbim të planifikuar.					
Qartësia e punonjësve për proceset e punëve që bëjnë.					
Zbatimi i të drejtave dhe detyrave dhe përgjegjësive ligjore.					
Efektiviteti në kohën e punës,					
Ndarjet e mbetjeve nga punëtorët gjatë shërbimit të grumbullimit të mbetjeve.					
Koha efektive në punë					

në proceset e punës					
Numri i punonjësve.					
Pagat së bashku me sigurimet.					
Veshjet me shenjat dalluese.					
Ngarkesa e kontrollorëve të punës					
Mbajtja e procesverbaleve prej kontrolluesve (supervisorëve)					

Të gjithë formatet e paraqitura më sipër u ofruan në mënyrë elektronike dhe kopje t të printuara.

**-Mënyra e ofrimi të shërbimit.**

Shërbimi ofrohet bazuar në një kontratë sipërmarrje “Për pastrimin, heqjen dhe transportimin e mbetjeve urbane në bashkinë e Kuçovës” e lidhur midis Bashkisë Kuçovë në datë 27.06.2011 me afat kohor prej pesë vitesh, e rinovuar në vitin 2016 me shoqërinë “Higjena” sh.p.k , me administrator të shoqërisë Z.Vasillaq Golemi. Shoqëria “Higjena” sh.p.k ka kompetencë të plotë për të vepruar dhe përfaqësuar shoqërinë në të gjitha marrëdhëniet me investitorin; në këtë rast Bashkia e Kuçovës, për realizimin e objektit të kontratës, për shërbimin e pastrimit, heqjes dhe transportimit dhe trajtimit në vend-depozitim të mbetjeve urbane.

Shoqëria ka fituar tenderin e hapur me një vlerë prej 21 046 175 lekë përfshirë TVSH-në, sipas zërave të mëposhtëm:

1. Fshirje me fshesë dore e rrugëve dhe shesheve	3 269 303 lekë
--	----------------

2. Fshirje me mjet teknologjik e rrugëve e shesheve	550 664 lekë
3. Heqja e mbeturinave nga pikat e grumbullimit	2 593 578 leke
4. Transportimi i mbeturinave në vend-depozitim	5 983 551 lekë
5. Shërbim pastrimi në WC –të publike	1 215 026 lekë
6. Lagia e rrugëve dhe shesheve me mjet teknologjik	1 426 536 lekë
7. Heqja e mbetjeve inerte nga mjediset publike	1 694 865 lekë
8. Sistemimi i mbeturinave urbane në vend-depozitim	804 956 lekë
Shuma	17 538 479 lekë
TVSH 20%	3 507 696 lekë
Shuma gjithsej	21 046 175 lekë

Kontrata e lidhur me bashkinë përban bazën ligjore, përkufizimet, objektin dhe afatin kohor, vlerën vjetore, analizat e kostos, detyrimet e sipërmarrësit, mënyrën e raportimit për shërbimin e kryer, numrin e punonjësve, edukimin mjedisor të publikut etj... Kontrata përmban edhe elementë të tjerë që rregullojnë të drejtat dhe detyrimet e palëve për realizimin e këtij shërbimi të tilla si specifikimet teknike dhe proceset që kryhen; plan-vendosjen e kontenierëve dhe grafikun e punimeve; përshkrimin e mjeteve të transportimit; volumet e punimeve dhe zonat ku ofrohet shërbimi etj...Sipas informacionit të marrë prej materialeve të bashkisë rezulton se Shoqëria “Higjena” sh.p.k, për kryer këtë shërbim ka investuar në:

- mjete teknologjike dhe mjete të tjera të ngjashme rreth 19,830,000 lekë;
- kontenierë metalikë rreth 1,951,000 lekë;
- investime në vegla pune etj. rreth 427,000 lekë;

Në total llogaritet se Shoqëria “Higjena” sh.p.k ka investuar me një vlerë rreth 22.2 milion lekë.

Me ndarjen e re territoriale bashkia Kuçovë ka ofruar shërbimin në qytetin e Kuçovës dhe në dy njësi administrative, Kozare dhe Perondi.

Në njësinë administrative Lumas, gjatë vitit 2017 ka patur inisiativa për të ofruar këtë shërbim, por gjithsesi nuk ka mundur ta realizojë plotësisht për shkak të vështirësive të rrugëve të transportit.

Në qytetin e Kuçovës, shërbimi i menaxhimit të mbetjeve ofrohet në të gjithë sipërfaqen që mbulon këtë bashki. Shërbimi ofrohet çdo ditë të javës në disa zëra kostoje si më poshtë:

- grumbullimi dhe transportimi i mbetjeve urbane me kontenierë e mjet teknologjik.
- heqja e mbetjeve solide (dhera, materiale inerte etj...) nga pikat e grumbullimit ose hapësira të tjera publike.
- sistemimi i mbetjeve urbane në vend-depozitim rreth 4 km larg qytetit Kuçovë

Në njësinë administrative Kozare, shërbimi ofrohet në të gjithë fshatrat e kësaj njësie si Kozare, Havaleas, Vlashuk, Salcë Kozare, Ferras, Fier Mimar, Gegë, Drizë, Frashër, Zdravë dhe Demollarë. Ky shërbim ofrohet 2 ditë në javë vetëm në dy zëra kostoje si:


- grumbullimi dhe transportimi i mbetjeve urbane me kontenierë e mjet teknologjik.
- heqja e mbetjeve solide (dhera, materiale inerte, barishte, degë pemësh etj.) nga pikat e grumbullimit.

Në njësinë administrative Perondi, shërbimi i pastrimit ofrohet pothuajse në të gjithë fshatrat e kësaj njësie si Perondi, Magjatë, Tapi, Rreth Tapi, Goraj, Polovinë, me përjashtim të fshatit Velagosht ku ofrohet pjesërisht vetëm në fillim të fshatit, deri aty ku e lejon infrastruktura rrugore, ku mund të kalojnë mjetet teknologjike. Ky shërbim ofrohet 2 ditë në javë në disa zëra kostoje (ose qëndra kostoje) si më poshtë:

- grumbullimi dhe transportimi i mbeturinave urbane me kontenierë e mjet teknologjik
- heqja e mbetjeve solide (dhera, materiale inerte, barishte, degë pemësh etj.) nga pikat e grumbullimit.

Ndërkohë, në njësinë administrative Lumas, në fillim të muajit Gusht 2016 ka filluar shërbimi i grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve urbane me kontenierë dhe mjet teknologjik, në tre fshatra si Sheqëz, Vodëz dhe Lumas, me 12 kontenierë në total me shërbim dy herë në javë. Në fshatrat e tjerë të kësaj njësie administrative si Pëllumbas, Belesovë, Mëndrakë, Luzaj, Katundas, Krekëz, Koritëz, Bardhaj dhe Pashtraj nuk mund të ofrohet ky shërbim për shkak të infrastrukturës së keqe rrugore.

## Rrugët që përshkojnë automjetet e transportit.



Harta e mësipërme ilustron infrastrukturën rrugore që lidh qytetin Kuçovë, qendrën e Bashkisë, me të gjitha fshatrat e njësisë administrative Kozare, Lumas dhe Perondi.

Në njësinë administrative Kozare, gjëndja e rrugëve ekzistuese është më e mirë, krahasuar me njësitë e tjera. Kjo është edhe arsyeja që në këtë njësi administrative shërbimi i grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve urbane ofrohet në të gjitha fshatrat që përfshihen. Sipas të dhënave që zotëron bashkia, distanca më e afërt e qytetit Kuçovë me fshatrat e njësisë administrative Kozare është Kuçovë-Havaleas me gjatësi 4.5 km dhe distanca më e largët është Kuçov-Salc Kozare është me gjatësi 11 km dhe Kuçovë-Fiermimar 9.3 km.

Gjendja e infrastrukturës rrugore në njësinë administrative Perondi paraqitet e mirë, me përjashtim të fshatit Velagosht ku mjetet e grumbullimit dhe transportimit mund të futen vetëm në hyrje të fshatit, por më tej mjeti teknologjik nuk mund të operojë që të realizohet shërbimi me konteniere e mjet teknologjik në hapësirën e plotë territorial të këtij fshati. Distanca më e afërt e qytetit Kuçovë me fshatrat e njësisë Perondi është Kuçovë-Perondi 1.5 km dhe distanca më e largët është Kuçovë-Goraj 6 km.

Në njësinë administrative Lumas gjendja e infrastrukturës rrugore është shumë e keqe. Me përjashtim të fshatit Sheqëz dhe Vodëz dhe pjesërisht të fshatit Lumas, territore ku gjenden rrugë të shtruara me asfalt, të gjitha rrugët e fshatrave të tjera kanë rrugë me çakull dhe në gjëndje jo të mirë për kalimin e makinave të rënda transportuese. Kjo është arsyeja përse bashkia Kuçovë nuk mund të vendosë shërbimin e grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve urbane me konteniere dhe mjet teknologjik në territorin e plotë të kësaj njësie.

Distanca me e afërt e qytetit Kuçovë, me fshatrat e njësisë Lumas është: Kuçovë-Vodëz 18 km dhe distanca më e largët është Kuçovë-Lumas 21 km. Këto teritore janë fshatra për të cilat ekziston mundësia që të futet shërbimi i grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve urbane. Në distanca të largëta si Kuçovë-Mendrake, 33 km, dhe në fshatra të tjerë të kësaj njësie si Belesovë, Pëllumbas, Luzaj, Katundas, Krekëz, Koritëz, Bardhaj dhe Pashtraj nuk mund të futet shërbimi i grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve urbane me kontenerë metalikë dhe mjet teknologjik.

Duke patur parasysh hartën e rrugëve që lidhin bashkinë qëndër Kuçovë me fshatrat e njësive administrative Kozare, Lumas dhe Perondi, të katër mjetet teknologjike, mesatarisht bëjnë rreth 35 km rrugë në ditë, kur ky shërbim ofrohet 6 ditë/javë në qytetin e Kuçovës, 3 ditë/javë në njësitë administrative Kozare e Perondi dhe 2 ditë/javë në njësinë administrative Lumas.

### **Vendi i grumbullimit përfundimtar, sipërfaqja dhe kushtet që plotëson.**

Vendi i grumbullimit përfundimtar për grumbullimin dhe sistemimin e mbetjeve urbane është në fshatin Rreth Tapi ose ish “Ferma Partizani”, rreth 4 km larg nga qyteti i Kuçovës, në një sipërfaqe prej rreth 12 500 m<sup>2</sup>, tokë pyjore e ish-ndërmarrjes bujqësore para viteve 1990. Ky vend depozitim ka filluar të funksionojë në vitin 1989 dhe vazhdon edhe në ditët e sotme. Ky territor është në pronësi të bashkisë, por administrohet nga sipërmarrësi i shërbimit të pastrimit “Higjiena” shpk.

Aktualisht, pika e grumbullimit është e pa rrethuar, gjendet një mal me mbetje të pandara që shkaktojnë ndotje mjedisore në tokë, nga ana tjetër djegjet nga persona të papërgjegjshëm vazhdojnë të shkaktojnë ndotje në ajër. Ka edhe qytetarë të papërgjegjshëm, që ndezin zjarr ose i përhapin mbetjet dhe marrin atë që duan. Pika e grumbullimit është e hapur dhe shkakton ndotje në tokë dhe në ajër.

Në vend depozitim u vërejt se në pjesën veriore të tij shtrati i lumit Devoll është afuar shumë, rreth 40-50m larg masës së grumbullimit të mbetjeve. Ndotja e ujrave të lumit Devoll është e evidente; rrjedhjet prej mbetjeve të kompostuara prej vitësh shkojnë në lumin Seman, e në vazhdim në kanalet vaditëse dhe përfundojnë në det.

Prej mënyrës së depozitimit të mbetjeve, ndotet edhe toka që ato mbulojnë pasi nuk janë zbatuar kushtet e ndërtimit të një “landfilli” me të gjitha specifikimet përkatëse teknike. Në 10 vitet e fundit mbetjet e hedhura pranë shtratit të lumit Devoll janë afuar në rreth 50 m nga afërsisht 150 m që ka qënë dikur. Vend depozitimi i mbetjeve urbane është një sipërfaqe toke me potencial të lartë përmblyetjeje, dhe ka përbërje të shtresave aluvionale ku rrjedhjet prej mbetjeve urbane ndotin ujin e lumit Devoll. Për këtë arsye bashkia Kuçovë është angazhuar në një proces për të ndërtuar një vend depozitim tjetër ose një “landfill” rajonal, duke e zgjidhur përfundimisht këtë problem urgjent e delikat. Në kuadrin e bashkëpunimit rajonal, bashkia ka ndërmarrë hapa konkretë për tu përfshirë në projektin që financohet nga Qeveria Zviceriane, përmes Sekretariatit të Shtetit për Çështje Ekonomike dhe SECO, e cila ka parashikuar financimin e projektit për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta në bashkinë e Beratit, përfshirë në UNESCO për trashëgiminë e tij kulturore, e cila do të shtrijë ndërhyrjen edhe në bashkitë Kuçovë, Poliçan, Çorovodë dhe Ura Vajgurore



Pamje nga vendi i grumbullimit përfundimtar të mbetjeve

### **Mjetet grumbulluese transportuese**

#### **-Sasia dhe gjendja e kazanëve.**

Për shërbimin e grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve urbane me kontenierë dhe mjet teknologjik Bashkia Kuçovë zotëron sasinë e inventarit në çdo njësi administrative. Bashkia ka vënë në dispozicion të shoqërisë që kryen shërbimin, një sipërfaqe godine 145 m<sup>2</sup> dhe një sipërfaqe trualli 781 m<sup>2</sup>, si dhe 120 kontenierë metalikë, me trashësi të llamarinës S=1.5-2mm, kundrejt tarifave të qerasë, si pjesë e pjesëmarrjes së saj në realizimin e shërbimit dhe për të lehtësuar procesin. Shërbimi realizohet nëpërmjet 29 punonjësve dhe në total asetet që zotëron kompania sipërmarrëse janë:

- 240 kontenierë metalikë, me trashësi të llamarinës S=1.5-2 mm me kapakë metalikë që të jenë të lehtë për t'u hapur me dorë, me 4 rrota për lëvizjen normale.
- 120 kontenierë 1.1 m<sup>3</sup> janë në pronësi të bashkisë të cilët janë marrë me qira mujore 30 lekë/kontenier/muaj nga kompania dhe 120 kontenierë janë në pronësi të kompanisë

Në njësinë administrative Kozarë janë vendosur për shërbim 90 kontenierë të shpërndarë në të gjitha fshatrat e kësaj njësie, duke mbuluar 100% zonën e shërbimit në këtë njësi administrative.



Në njësinë administrative Perondi janë vendosur 95 kontenierë metalikë të shpërndarë në fshatrat e kësaj njësie administrative, duke bërë të mundur mbulimin rreth 90% të zonës së shërbimit në këtë njësi administrative.

Në njësinë administrative Lumas janë vendosur 12 copë kontenierë metalike me kapacitet  $1.1 \text{ m}^3$ , të shpërndarë si në vijim:

- 4 kontenierë në fshatin Vodëz
- 3 kontenierë në fshatin Sheqëz
- 5 kontenierë në fshatin Lumas

Deri në vitin 2012 në bashkinë Kuçovë ka patur rreth 150 kosha të vegjël rrugorë, të vendosur në rrugët kryesore në qendër të qytetit, në park dhe në lulishte. Pas këtij viti nuk ka më kosha të vegjël në rrugët e qytetit Kuçovë, sepse ka shumë gjasa që ata të jenë vjedhur nga persona të papërgjegjshëm për t'u shitur për skrap.

Në njësinë administrative Kozare dhe në Lagjen "Tafil Skëndo", përta i përket koshave të vegjël në trotuare, ato mungojnë, nuk ka asnjë kosh. Një pjesë e vendeve të kontenierëve duhet të jenë më të pastër dhe kanë nevojë për më shumë gëlqere e klor. Në këtë lagje, gjëndja e kontenierëve, në përgjithësi është e mirë po ka nevojë për përmirësim, si lysterje me bojë apo edhe ndonjë riparim tjetër i vogël. Është vënë re se kontenierët janë pa kapakë pasi ato janë hequr me vetëdije rreth vitit 2008, për shkak se nuk funksionon mekanizmi i hapjes së tyre me dorë për difekt të kompanisë së prodhimit të kontenierëve, e provuar kjo edhe me vëzhguesit e kontenierëve.

Në territorin që përfshin "Rruga Mapo-Shtëpia e N.Kapllani, tek pallati 5K i TEC-it dhe tek pallati 5-K i Aviacionit, kontenierët janë në gjendje të mirë, vendi i kontenierëve dhe përreth tyre mbahet i pastër, përgjithësisht janë të dezinfektuar me gëlqere e klor, shërbimi kryhet në mënyrë të rregullt, kontenierët në të shumtën e rasteve gjenden të zbrazur, por ata nuk janë të lyster me bojë antiruxho, ose me varak.

Tek zona sipër shkollës "G.Karakashi", shpesh gjenden të hedhura mbetje inerte dhe degë pemësh përreth kontenierëve, pra nuk ka sjellje të mirë qytetare. Ndërsa tek Kabina Elektrike gjëndja paraqitet ndryshe; kontenierët mbahen në gjendje të mirë, por vendet e kontenierit e përreth tij nuk janë të pastër, ka presencë të mbetjeve urbane të hedhura jashtë tyre të tilla si qese dhe portokalle dhe ushqime të tjera.

Në pikat e tjera të grumbullimit të mbetjeve të këtij blloku kontenieret nuk janë të lyster me boje antiruxho ose varak. Ka raste kur kontenieri është në gjendje të mirë, ndërsa vendi i kontenierit dhe përreth tij nuk është i pastër, për shkak të papastërtive që vihen re; dezinfektimi me gëlqere dhe klor nuk kryhet në nivelin e kërkuar. Mungojnë mbishkrimet në faqen ballore të tyre: "Të gjithë për një mjedis të pastër"!

Në lagjen 11-Janari kontenierët janë në gjendje të mjerueshme. Ata nuk plotësojnë kushtet minimale përsa i përket kapakëve apo rrotave të cilat mungojnë. Vëndi ku janë vendosur kontenierët nuk është e betonizuar dhe nuk kanë rrethim. Kontenierët nuk janë të lyster dhe nuk ka ndarje për mbetjet, të gjitha mbetjet hidhen në të njëjtin vend.

Në Perondi kontenierët janë në shumicën e rasteve shumë të vjetër. Ata nuk kanë kapak, dhe në disa raste nuk kanë rrota ose më së shumti gjenden me 1-2-3 rrota por jo me katër. Disa prej tyre janë të kalbur dhe kanë rrjedhje.

Në njësinë administrative Lumas, nga vëzhgimet e kryera u vu re se kontenierët janë të gjithë pa kapak dhe shumë të vjetër. Shumica e tyre janë të kalbur, pa rrota, të pa lyster, pa numra dhe pa emrin e firmës.

Pamjet e mëposhtme ilustron gjëndjen aktuale të kontenierëve në Bashkinë Kuçovë dhe pikërisht gjëndjen e mirë në qendër të qytetit, situatën me problem në vendbanime në thellësi të lagjeve të qytetit dhe problematikën e ngarkuar në njësi administrative në zona të ish-komunave.



### Mjetet teknologjike

Në bashkinë Kuçovë shërbimi e menaxhimit të mbetjeve kryhet më së shumti prej tre mjeteve kryesore transportuese; një mjet teknologjik Tip “Man 18-192” me kapacitet 8T, i cili është në gjendje të mirë teknike, pavarësisht se viti i prodhimit është 1992. Duhet theksuar fakti që kjo makinë teknologjike është e vjetër, kërkon ndërhyrje riparimi të shpeshta, me kazan që rrjedh dhe që riparohet shpesh. Mjeti është me ngarkim nga pas me raport kompaktimi 1:6. Ky mjet teknologjik mban ngarkesën kryesore në grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve urbane në qytet dhe në njësitë e tjera administrative.

Mjeti tjetër teknologjik në gjendje të mirë teknike, është i tipit “Man 16-192” me kapacitet 7.4T. Edhe pse është i vitit 1985 i prodhimit , ai kryen ngarkim nga pas me raport kompaktimi 1:6. Edhe ky mjet teknologjik mban peshë të rëndësishme në grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve urbane në qytet dhe në njësitë e tjera administrative.

Një mjeti tjetër teknologjik është me vit prodhimi 2001, me ngarkim anësor me raport kompaktimi 1:6. Ky mjet teknologjik është lehtësisht i manovrueshëm dhe përdoret më shumë për të grumbulluar mbetjet nga kontenierët që janë në rrugë të ngushta dhe me infrastrukturë jo të mirë në qytetin e Kuçovës. Ngjyra e këtyre mjeteve nuk është e njëjtë për të dalluar që janë makinat e heqjes dhe transportimit të mbetjeve të bashkisë. Vlerësimi në mënyrë të përgjithshme për këto mjete është i mirë por ka nevojë për më tepër përmirësim; ato duhet të jenë më të pastra dhe më të rregullta. nuk kanë numra identifikues, nuk janë të lyera dhe nuk kanë simbolet e firmës të cilës i përkasin. Teknologjia që ato përdorin nuk është e mirë pasi ato janë pjesërisht të amortizuara.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhënat për mjetet e transportit që zotëron bashkia, të cilat përdoren nga Shoqëria “Higjena” sh.p.k me administrator Z. Vasillaq Golemi.

<b>N r</b>	<b>Lloji i mjetit</b>	<b>Kapaciteti</b>	<b>Viti prodhimit</b>	<b>Viti i blerjes</b>
<b>1</b>	Automjet teknologjik për mbledhjen & transportin e mbetjeve me kontenierë MAN -16/92	6 Ton	1981	1998
<b>2</b>	Automjet teknologjik për mbledhjen & transportin e mbetjeve me kontenierë MAN -17-192	8 Ton	1992	2006
<b>3</b>	Automjet teknologjik për mbledhjen & transportin e mbetjeve me kontenierë metalik Benz-814-D	2 Ton	2001	2011
<b>6</b>	Automjet teknologjik për larjen e kontenierëve e të rrugëve Benz – 1824	10 Ton	1995	2014

7	Automjet vetëshkarkues MAN-W 8-150	3.6 Ton	1990	2003
8	Automjet vetëshkarkues IVECO 49-10	3.2 Ton	1993	1996

### **Proceset që kryhen:**

Proceset bazë janë mbledhja, largimi dhe transporti i mbetjeve. Sasia e mbetjeve ditore të prodhuara është vlerësuar 22.5 ton/ditë.

Kompania kryen:

- zbrazjen e kontenierëve me makinë teknologjike,
- mbledhjen dhe largimin e mbetjeve rreth kontenierit në një rreze 3 metër nga kontenieri,
- pastrimin dhe fshirjen me fshesë dore të vendit të kontenierit në një sipërfaqe 7 m<sup>2</sup> rreth kontenierit,
- rivendosjen e kontenierëve në vendin e caktuar.
- pastrimin e territorit urban të caktuar,
- heqjen e mbetjeve solide nga pikat e grumbullimit dhe hapësirat e tjera publike.
- heqjen e materialeve inerte dhe dherave në të gjithë zonën e kontratës.
- grumbullimi dhe transporti i mbetjeve voluminoze si pajisje, karkasa makinash, mbetje bimore, mobilje, orendi, e sende të tjera që nuk mund të hidhen në kontenierët 1.1 m<sup>3</sup>.

Procesi përfshin edhe sistemimin e mbetjeve urbane në fushën e depozitimit të tyre në fermën “Rreth-Tapi”, 65 ditë/vit me skrep ose traktor me thikë.

### **-Koha reale e nisjes së grumbullimit të mbetjeve**

Sipas vëzhgimit në terren, grumbullimi i mbetjeve fillon në ditë të ndryshme në orare të ndryshme; nuk ka një orar fiks. Në njësinë vendore Lumas dhe Perondi u vu re se mbledhja e mbetjeve bëhet gjatë paraditës, rreth orës 9-të deri në orën 11-të, apo në raste të caktuara edhe më vonë; ka patur raste edhe pas orës 12-të të pasdrekës. Kontrata detyron që i gjithë procesi i grumbullimit duhet të ketë mbaruar para orës 10. Nuk ka ditë dhe orar të përcaktuar për çdo zonë e shoqëruar kjo edhe me emrat e punonjësve dhe mjeteve transportuese përkatëse. Puna për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve me mjet teknologjik fillon në orën 04 të natës. Në të gjithë zonën e shërbimit punojnë tre mjete teknologjike, ku secili ka zonën e vet. Në të dy mjetet teknologjike me kapacitet 8T, çdo njëri prej

tyre trajton rreth 100 konteniere, kurse mjete i vogël 3T merr rreth 40 konteniëre. Sejcili mjet teknologjik mbushet për 4-5 orë; procesi e grumbullimit dhe mbushjes së mjeteve duhet të përfundojë rreth orës 9.30-10.00. Pas kësaj kohe mjetet shkojnë në vend-depozitim.

Duke filluar nga ora 10.00 mjetet teknologjike shkojnë për në vend-depozitim për të shkarkuar mbetjet urbane që kanë grumbulluar nga kontenierët. Edhe pse në kontratë citohet që procesi duhet të ketë mbaruar para orës 10 të mëngjezit, kamioni vjen në landfill pothuajse gjithmonë pas orës 11, dhe në raste të caktuara dhe në orën 13.00. Koha e zbrazjes ndryshon nga dita në ditë. Nga vëzhgimi u vërejt se në ditë të veçanta makina transportonte mbetje për në landfill edhe pas orës 13.00.

Duke patur parasysh edhe kohën që duhet për të shkuar në vend-depozitim, rreth 4 km larg qytetit, dhe kohën e shkarkimit të mbetjeve në vend depozitim, u evidentua se rreth orës 11.00-12.00 përfundon procesi i grumbullimit e transportimit të mbetjeve urbane në të gjithë territorin e bashkisë.

Si konkluzion mund të themi se përderisa mbledhja e mbetjeve në zonat kryesisht periferike kryhet me vonesë normalisht që edhe në qendrën e grumbullimit shkojnë jashtë orarit të përcaktuar në kontratë.

#### -Koha e kthimit mbrapsht në vendparkim.

Në orën 12:30, makinat kthehen në vendparkim, një kohë që konsiderohet e përshtatshme, edhe pse ndonjëherë ndryshon në varësi të proceseve të punës.

Pas parkimit të tyre në vendin ku është ambjenti i firmës sipërmarrëse “Higjiena” shpk. shoferët (mekanikët) fillojnë të kryejnë shërbimet teknike rutinë në mjetet e tyre të punës, për të qënë në gatishmëri për ditën tjetër.

#### -Sasia e fshirjeve dhe larjeve ditore

Në periudhën kohore që u realizua verifikimi në terren vëzhguesit, nuk ndeshën me asnjë rast ku makinat fshirëse dhe larëse të ofronin shërbimin përkatës. Nga ana tjetër sipas informacionit të marrë nga bashkia, shërbimi i fshirjes së rrugëve e shesheve bëhet me fshesë dore në sipërfaqen prej 140 000 m<sup>2</sup> dhe me autofshesë në sipërfaqe prej 30 000 m<sup>2</sup> në rrugët në qendër të qytetit. Shërbimi i fshirjes me dorë ofrohet 6 ditë në javë, kurse fshirja me autofshesë ofrohet 80 ditë/vit.

Shërbimi i lagjes së rrugëve e shesheve bëhet me autobot me kapacitet 10 m<sup>3</sup> në sipërfaqen prej 50 000 m<sup>2</sup> për 207 ditë në vit e ndarë, sipas periudhave të paracaktuara.

Për të dy shërbimet atë të fshirjes së rrugëve e shesheve dhe të lagjes së tyre, mund të themi se shërbimi nga firma sipërmarrëse e pastrimit kryhet përgjithësisht në kohë dhe me cilësi të mirë. Në Perondi larja me makinë bëhet me raste, ndërsa fshirja e rrugëve kryhet vetëm me fshesë dore.

#### 4)Pajisja me kod e kamionit dhe kontenierëve.

Mungon pajisja me kod e kontenierëve dhe kamionit. Nga vëzhgimi i kryer tek automjetet dhe kontenierët nuk u vërejt ndonjë “kod” ose “numër” i vendosur mbi ta, por mbi të gjithë kontenierët dhe automjetet ishin shkruar fjalët “Higjiena” shpk Kuçovë dhe numri i telefonit **0311 44 80**. Ky numër është shkruar për t’i bërë me dije të gjithë qytetarët në raste kur kanë ndonjë shqetësim, ose ankesë për shërbimin e pastrimit me qëllim që ata të komunikojnë në mënyrë të drejtëpërdrejtë, për të zgjidhur probleme të ndryshme.

- Riparimet e kontenierëve me problem.

Ndërhyrja tek kontenierët ka nevojë për shumë përmirësim. Në Lumas shumica e tyre janë të pa kapak dhe pa rrota dhe rrjedhin lëngje sepse janë të çarë në pjesën e poshtme të tyre. Pothuajse të gjithë janë me probleme, nuk vërehet asnjë i rregullt, i lyster, i pastër, me kapak dhe me simbolet dalluese. Ka një sasi prej tyre që duhet të hiqen menjëherë dhe të riparohen. Gjatë procesit të punës për grumbullimin e transportimin e mbetjeve një pjesë e kontenierëve dëmtohen, ndryshket llamarina në pjesën e poshtme apo dëmtohen ose vidhen rrotat e tyre. Duhet theksuar se vëzhguesit në Lumas nuk kanë patur njohuri se disa prej kontenierëve i përkasin një kompanie sipërmarrëse e kontratuar me bashkinë Berat që ofron shërbim në fshatin Lapardha 1, Lapardha 2, dhe në një pjesë të fshatit Çiflik. Këta kontenierë të vendosur pranë rrugës kryesore që shkon në Lumas, janë të palyer, pa rrota dhe të ndryshkur si paraqitet edhe në fotot përkatëse.

Bazuar në analizat e kostos, bashkia ka parashikuar një fond prej 270 00 lekësh në vit për riparimin, vendosjen e rrotave dhe lysterjen e kontenierëve të dëmtuar. Riparimi kryhet nga mekanikët e firmës sipërmarrëse. Ky fond për riparimin e kontenierëve kontrollohet nga supervizori i bashkisë.

- Sasia itinerareve dhe e orëve të punës së kamionëve

Itenerari është përcaktuar sipas kontratës dhe zbatohet sipas grafikut ditor-javor-mujor. Ndonjëherë ka ndryshime për oraret për shkak të ndonjë difekti të mjeteve motorike.

Sasia e itinerarëve dhe e orëve të punës shpesh ndryshojnë nga dita në ditë në varësi të punës, kështu që ka momente të caktuara që kamionët dalin në punë dhe dy herë në ditë.

Është hartuar një grafik për itinerarin e mjeteve teknologjike ku përfshihen edhe dy njësitë administrative Kozare e Perondi. Sipas këtij grafiku shërbimi i grumbullimit e transportimit të mbetjeve urbane ofrohet 6 ditë/javë në Kuçovë dhe 3 ditë/javë në Kozare e Perondi.

Për të gjithë bashkinë çdo mjet lëviz mesatarisht 8.75 km për çdo ditë, kurse sasia e mbetjeve është 26.8 ton/ditë.

-Përputhja në orare e makinave dhe pajisjeve.

Nuk ka përputhje oraresh; gjithshka varet nga sasia e mbetjeve të gjendura në kontenierë, prandaj shpesh grumbullimi realizohet edhe pasdite. Duke qënë se firma sipërmarrëse e pastrimit “Higjiena” shpk Kuçovë kryen shërbimin edhe në njësitë administrative Kozare e Perondi, ajo mundohet të kombinojë në kohë sidomos oraret e mjeteve teknologjike. Prej vëzhguesve nuk u raportua ndonjë ankesë prej qytetarëve për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve urbane dhe përputhja në orare bëhet në kohën e duhur, pa sjellë problem për

shërbimin. Rasti i mospërputhjes së orareve ndodh kur makina që lan rrugët e kryen veprimin para se të bëhet heqja dhe pastrimi i mbetjeve përreth koshave apo në vende të tjera informale.

- Përpunimi i mbetjeve në vëndin e depozitimit.

Pika e grumbullimit të mbetjeve është e pa rrethuar, gjendet një mal me mbeturina të pandara që shkaktojnë ndotje mjedisore në tokë, nga ana tjetër djegjet nga persona të papërgjegjshëm shkaktojnë ndotje në ajër. Aty pranë ndodhet dhe lumi e sigurisht që ndoten ujërat e tij dhe shpërndajnë mbeturina edhe në vende të tjera. Nuk ka roje të vendosur në landfill.

Mbetjet nuk përpunohen në vëndin e depozitimit, thjesht grumbullohen aty, gjendja është shumë e keqe, duhet të gjendet një zgjidhje. Deri tani nga firma sipërmarrëse e pastrimit dhe bashkia Kuçovë nuk bëhet përpunimi i mbetjeve në vend depozitimin e tyre. Vëzhguesit konstatuan se në vend-depozitim bëhet vetëm një sistemim i mbetjeve me traktor me thikë e zinxhirë. Por ky shërbim kryhet vetëm 65 ditë në vit, kështu që mund të themi se ky process pune ka nevojë për më shumë përmirësim.

-Djegja në ambjent të hapur.

Janë vënë re djegje në ambjent të hapur, gjë që bie në kundërshtim me kontratën. Tymi dhe era që del nga djegja e mbeturinave arrin deri në lagjen tek ferma Partizani (rreth-Tapi) dhe në Fier-Mimar në njësinë administrative Kozare. Gjatë kohës së vëzhgimeve është vënë re se ka patur tym prej djegjes pothuajse çdo ditë. Nga informacioni i përfutur, Bashkia Kuçovë ka marrë disa masa për të shmangur djegjen e mbeturinave në vend-depozitim:

- -ka caktuar një person që të kujdeset për gjithshka ndodh në vend depozitim.
- -nuk lejohet asnjë i vetpunësuar të ndezë zjarr, ose të bëj veprime që favorizojnë zjarrin.
- -në rast zjarri, mjeti teknologjik është në gadishmëri për lagje me ujë me kapacitet 10 m<sup>3</sup>, i cili ndërhyt dhe e shuan.

-Ndotja mjedisore në tokë apo në ajër.

Vend-depozitimi ndodhet pranë lumit Devoll e sigurisht që ujërat e tij ndoten dhe shpërndajnë mbetje edhe në vende të tjera. Ndërkohë qytetarë të papërgjegjshëm ndezin zjarr ose i përhapin mbetjet dhe marrin atë që duan për interes të tyre. Pika e grumbullimit është e hapur dhe shkakton ndotje në tokë dhe në ajër.

Në vend depozitimi ndodhet në pjesën veriore të tij shtrati i lumit Devoll dhe mbetjet gjenden shumë afër, rreth 40-50m larg masës së grumbullimit të mbetjeve. Ndotja e ujrave të lumit Devoll është e evidente; rrjedhjet prej mbetjeve të kompostuara prej vitesh shkojnë drejt e në lumin Seman, dhe përfundojnë në det. Por edhe toka ndotet pasi nuk janë zbatuar kushtet e ndërtimit të një “landfilli” i cili të plotësojë të gjitha kushtet teknike.

- Mbulimi me shërbim i territorit

Territori nuk mbulohet plotësisht, ka nevojë për më shumë përmirësim sidomos me plotësimin me konteniervë të rinj dhe me shërbim cilësor ashtu si kryhet në zonën urbane në qendër të qytetit. Pasi është vëzhguar i gjithë territori është evidentuar se qendra ka kushte më të mira dhe shërbimi që ofrohet është i mirë por ka zona të caktuara sidomos ato larg qendrës ku koshat nuk egzistojnë dhe mbetjet hidhen në tokë, fenomen që sjell problematika shumë të rrezishme për jetën e njerëzve. Duhet theksuar se akoma nuk ka përcaktim të saktë e të plotë të territorit ku bashkia Kuçovë ofron shërbim bazuar në standarte të miratuara

#### -Zbrazja dhe sistemimi përreth konteniervë

Konteniervët zbrazen në mënyrën e përcaktuar në rregullore, por vendi përreth nuk sistemohet, pra ka nevojë për shumë përmirësim. Vihet re se në disa zona konteniervët nuk ndodhet në një vend të përshtatshëm, madje mund të bëhet shkak për aksidente. Në rrugën nacionale Kozare-Fiershegan në disa vende kazanët ndodhen në korsinë e rrugës duke u bërë pengesë e shkak për mundësi aksidenti. Zona ku qëndron kazani nuk është e betonuar apo e rrethuar me beton.

Përsa i përket zonës Kozare u vërejt se konteniervët zbrazen dhe vendi përreth sistemohet çdo ditë.

Në përgjithësi zbrazja dhe sistemimi i konteniervëve bëhet mirë, por ka raste kur edhe pse është realizuar zbrazja e konteniervëve, është dezinfektuar vendi rrethëqark me gëlqere pluhur e klor, konteniervët pozicionohet keq, sepse nuk vendoset me pamje në faqen e dukshme ku janë shkruar fjalët “Të gjithë për një mjedis të pastër”. Ky kontenierv nuk e luan efektin edukues ambjental për qytetarët, për të patur një qytet sa më të pastër. Ky fenomen vihet re edhe në disa vende të tjera ku hidhen mbetjet urbane.

Në zona periferike kjo procedurë nuk është në nivelin e duhur sepse edhe kur konteniervët ndodhen në vendin e caktuar mbetjet hidhen jashtë tyre. Kjo ndodh sepse në disa raste konteniervët janë të tejmbushur dhe në raste të tjera janë qytetarët ata që nuk i hedhin mbetjet brenda në kontenierv por jashtë tyre. Nuk ka ndërhyrje nga bashkia për gjatë të qytetarëve për ndotje dhe dëmtim të pronës publike.

#### -Pastrimi dhe dizinfektimi rrethëqark konteniervëve

Në vende të caktuara periferike nuk kryhet dizinfektim rrethëqark konteniervëve, dhe gjendja lë shumë për të dëshiruar.

Në qendër në zonë urbane situata është ndryshe; pastrimi e dizinfektimi i vendit të konteniervëve bëhet mirë, por në ndonjë rast si tek shkolla “G.Karakashi”, vendi i konteniervëve nuk është dezinfektuar në sasinë e duhur me gëlqere e klor, ka një rrotë të deformuar, dhe vendi rreth e qark konteniervëve ka barëra të shkulura të hedhura si edhe mbeturina të vogla. Punëtorët e shoqërisë sipërmarrëse të pastrimit nuk bëjnë kujdesin e duhur për ta rregulluar situatën.

#### - Shmangia e humbjeve, derdhjeve apo rrjedhjeve.

Në përgjithësi makinat nuk tejmbushen me mbetje urbane. Nga vëzhgimet e kryera nuk janë vënë re derdhje apo rrjedhje përtej mjeteve teknologjike.



Nga vëzhgimi i bërë gjatë një kohe prej më shumë se një jave, automjetet vetëshkarkuese që përdoren për të hequr mbetjet inerte nga pikat e grumbullimit ose nga ambiente të tjera publike ishin të mbushura deri tek niveli i spondeve, pra nuk ishin të tejmbushur që të bëheshin shkak për derdhjen e mbetjeve në rrugët e qytetit.

- Sasia e mbetjeve të pagrumbulluara në fund të procesit ditor.

Sasia e mbetjeve të pagrumbulluara nuk është e madhe në fund të të procesit ditor. Nga vëzhgimi i bërë në të gjithë kontenierët e lagjies Nr.2, blloku “Ll.Prifti” u konstatua se në të gjitha pikat e grumbullimit shërbimi kryhej shumë mirë, ishin zbrazur të gjithë kontenierët, ishte kryer dezinfektimi me gelqere e klor. Në përgjithësi në zonat e banimit në qendër vendi përreth kontenierëve është i pastër, dhe në fund të procesit nuk ka mbetje urbane të pa grumbulluara e të pa transportuara.

16)- Trajtimi i mbetjeve për kompostim

Sasia e mbetjeve për kompostim është e madhe, por ajo gjëmdet në pikën e vend-grumbullimit. Nuk kryhet procesi i kompostimit dhe nuk dihet se çfarë ndodh me mbetjet e grumbulluara, vendi nuk është i rrethuar, vihet re thjeshtë një mal me mbetje të ndryshme të pandara. Afër vendgrumbullimit ndodhet edhe një thertore dhe një stallë derrash të cilat me raste shkojnë dhe ushqehen me çfarë mund të gjejnë në mbetjet e hedhura në landfill. Në bashkinë Kuçovë aktualisht nuk ka sasi të mbetjeve urbane që ndahen e shkojnë për kompostim.



**- Punonjësit e përfshirë në kryerjen e këtij shërbimi**

a)-Marrja dhe qëndrimi në punë e punonjësve

Punonjësit merren në punë pasi sipërmarrësi i pastrimit është bindur në aftësinë e tyre. Shumica e punëtorëve kanë kohë të gjatë në atë vend pune dhe kanë eksperiencë shumëvjeçare. Në përgjithësi marrja dhe qëndrimi në punë bëhet në bazë të aftësive, punonjësit kanë raport mjekësor i cili dëshmon se janë të aftë për punë dhe punët janë ndarë në bazë të aftësive. Aftësia e tyre vërehet në veprimet që

kryejnë në procesin e zbrazjes së konteniereve në mjetin teknologjik, pastrimin e vendit të konteniervë dhe përreth tyre, si dhe dezinfektimin e tyre me gëlqere dhe klor. Punonjësit instruktohen dhe ata firmosin kartelën e sigurimit teknik. Ata marrin raport mjekësor nga KMCAP. Shpesh punëtorët nuk i mbajnë mend rregullat e sigurimit teknik dhe ky fakt mund të rezultojë në rrezikim të jetës së tyre. Edhe pse kohë pas kohe janë kryer trajnime kërkohet që ato të jenë më të shpeshta.

b)- Njohja dhe përdorimi i mjeteve dhe pajisjeve.

Punëtorët njihnin të gjitha mjetet dhe dinin se si ti përdornin ato. Punonjësit janë vëzhguar dhe janë vlerësuar të aftë për manovrimin e mjeteve teknologjike si dhe kryerjen e proceseve të punës të tilla si marrjen, zbrazjen e konteniereve dhe dezinfektimin e tyre rrethqark në fund të këtij procesi. Ky fakt u konstatua në të tre mjetet teknologjik që u vëzhguan, si dhe me grupet e punëtorëve që punojnë në këto mjete teknologjike. Shoferët janë të kualifikuar dhe të pajisur me patentë të klasit C (grupi i të tretë ) dhe patente ÇAP (për kamionë).

c)-Zbatimi i rregulloreve të përcaktuara.

Jo në të gjitha rastet punonjësit zbatojnë rregulloren, sepse u vërejt se ata hipin makinës në ecje e sipër apo i qëndrojnë afër në momentin kur kamioni vetëshkarkon kontenerin. Shpesh punonjësit nuk përdorin maska, e mjete të tjera mbrojtëse, dhe mënyra sesi varen në spontin e makinave tregon se nuk e zbatojnë rregulloren, pra ka nevojë për pak përmirësim dhe forcim të zbatimit të rregullores.

Firma sipërmarrëse e pastrimit disponon “rregullore të brendshme” për rregullat e sigurimit teknik gjatë proceseve të punës që kjo firmë sipërmarrëse kryen për shërbimin e pastrimit.Kjo rregullore përmban të gjitha procedurat që duhet të zbatohen nga drejtuesit e mjeteve teknologjike, nga fshesarët dhe punëtorët e pastrimit t WC-ve, nga punëtorët që grumbullojnë dhe transportojnë mbetjet urbane dhe nga punëtorët që heqin e transportojnë mbetjet inerte. U konstatua se në përgjithsi kjo rregullore njihej nga punëtorët dhe drejtuesit e mjeteve teknologjike. Rregullorja ripunohej çdo tre muaj kur benin testin dhe instruktimin për rregullat e sigurimit teknik në punë.

Një kopje e kësaj “rregulloreje të brendshme” gjëndet e fotografuar në fund te këtij raporti narrative. Janë vërejtur disa raste kur punëtorët nuk mbajnë maska dhe kaskë mbrojtëse.

d)-Përgjegjësia dhe detyrat e ndara.

Në kryerjen e këtij shërbimi janë të punësuar 30 punonjës.Në përgjithësi detyrat ishin të ndara, secili kryen punën e vet,shoferi është shofer, punëtori është punëtor. Ky i fundit merret me zbrazjen e konteniervë, fshesaxhiu fshin, tjetri mbledh hedhjet jashtë kontenerit etj... Ka një organigramë me detyra për çdo sektor dhe për çdo punonjës. Ekonomisti dhe inxhinieri i mjedisit punojnë me kohë të pjesëshme.Ka një përgjegjës me kohë të plotë që kontrollon çdo ditë proceset e punës sipas sektorëve. Në raste të caktuara janë vërejtur edhe neglizhime ashtu si përmendet edhe në vlerësimet e mësipërme.

e)-Ndarja e detyrave me përshkrimin e qartë të punës që duhet të kryhet.

Në bazë të organigramës, çdo punëtor, sipas sektorit që ai punon i ka të qarta detyrat e tij dhe këto ai i realizon në procesin e punës ditore që kryen.

Ka raste kur punëtori i grumbullimit e transportimit të mbetjeve urbane mund të punojë edhe si punëtor për heqjen e mbetjeve inerte. Në rastet kur është parë e nevojshme për të ndryshuar sektorin e tyre për të punuar në një sektor tjetër, puna është kryer me cilësi e lehtësi nga punëtorët.

Ndërkohë nga vëzhgimi i kryer rezulton se punonjësve duhet t'u bëhet një përshkrim sa më i mirë dhe më i detajuar i proceseve të punës që ata duhet të kryejnë.

Ka nevojë akoma për përmirësim pasi u vërejt se ata nuk kishin bërë ndonjë trajnim të detajuar me punonjësit. Punonjësit kanë nevojë për një përshkrim më të detajuar që ata të mund të jenë më të qartë.

#### f)- Njohja dhe zotërimi i proceseve të punës.

Në përgjithësi punonjësit ishin të aftë dhe e njihnin mirë proceset që duhet të kryenin çdo ditë. U konstatua se çdo punëtor ka kartelën e vet dhe është instruktuar, për rregullat e sigurimit teknik në punë, si dhe me proceset tjera që ai duhet të kryejë. Në fund të këtij instruktimi ai firmos në kartelën personale. Instruktimi i punëtorëve bëhet rregullisht çdo tre muaj, ku pas instruktimit çdo punëtor firmos në kartelë, siç tregohet në fotot në fund të këtij raportimi.

Në përgjithësi njihen proceset e punës por ka vend edhe për përmirësim të mëtejshëm në zbatimin e zotërimin e proceseve të punës.

#### g)- Zbatimi i grafikëve të punës me oraret apo me shërbim të planifikuar.

Grafikët përgjithësisht zbatohen por ka nevojë për përmirësim sepse nga vetë lloji i punës nga proceset ka përplasje oraresh dhe ndryshim grafikësh nga dita në ditë por punohet 6 ditë në javë dhe e diela është pushim. Ka raste kur mjetet transportuese prishen gjatë rrugës ose bllokohen në trafik kështu që ka edhe ndryshim nga oraret e parashikuara të grafikëve.

Gjatë kohës së vëzhgimit të proceseve të punës nga punëtorët e firmës sipërmarrëse të pastrimit u vërejt se puna për grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave nuk filloi në orën 02.00 siç është saktësuar në kontratë, por në orën 04.00. Nga verifikimi i mëtejshëm doli në pah se ky fakt ndodhi si rrjedhojë e dimrit të ftohtë, ndërsa në verë zbatohet orari sipas kontratës me bashkinë. E njëjta gjë u vërejt edhe me fshesarët kur ata e fillojnë punën në orën 03.30 dhe jo në orën 02.00 sipas kontratës. Sipas vëzhguesve nga kontakti me punonjësit u prezantua ideja që të shikohet mundësia e ndryshimit të orarit të punës sipas stinëve të vitit. Ky ndryshim mund dhe duhet të bëhet në kontratën e punës që do të lidhet në të ardhmen me firmën sipërmarrëse të pastrimit, e cila do të fitojë tenderin e këtij shërbimi. Grafikët zbatohen në varësi të situatës. Punohet 6 ditë në javë. Vetëm dita e dielë është pushim.

Në Lumas u vëzhgua se oraret nuk zbatohen dhe sipas bisedave të kryera me punonjësit ata u shprehën se kjo vjen nga mbingarkesa që ata kanë. Shërbimi që ofrohet mbulon territor me hapësirë shumë të madhe ndërsa punonjësit dhe mjetet janë të pakët në numër. Nga

informacioni i marrë prej drejtuesëve të bashkisë, përgjegjës për këtë shërbim, rezulton se në Lumas shërbimi ofrohet vullnetarisht nga shoqëria sipërmarrëse, një herë në javë, me 12 kontenierë të vendosur me qëllimin e mirë për t'i edukuar banorët që në të ardhmen të kenë një shërbim të plotë duhet të paguhet tarifa e shërbimit. Mjeti teknologjik i mbledh mbetjet një herë në javë dhe detyrimisht nuk ka respektim të orareve të shërbimit.

h)-Qartësia e punonjësve për proceset e punës që kryejnë.

Në përgjithësi punonjësit ishin të qartë në lidhje me proceset e punës që bënin. Punonjësit i kanë të qarta proceset e punës por duhet që edhe të zbatohen sepse kjo nuk ndodh në të gjitha rastet. U vërejt se jo të gjithë janë të qartë në lidhje me proceset e punëve; ka nevojë për informim të mëtejshëm.

i)-Zbatimi i të drejtave dhe detyrave e përgjegjësive ligjore.

Punonjësit bëjnë punën por nuk njohin të drejtat e tyre; kanë mungesë informacioni, nuk e njohin kodin e punës. Një pjesë e tyre nuk janë në gjendje të rendisin të drejtat e tyre, si p.sh. e drejta e pushimit, e drejta e pagës, e drejta për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore etj... Kjo do të thotë se nga firma sipërmarrëse e pastrimit duhet të punohet më shumë në këtë drejtim, të qartësohen punëtorët jo vetëm për detyrat, por edhe për të drejtat e detyrimet e tyre ligjore.

j)- Efektiviteti në kohën e punës.

Punonjësit e pastrimit janë shumë efektivë. U vërejt se punonjësit bëjnë punë të mbingarkuar. Një pjesë e mirë e tyre janë shprehur që lodhen shumë dhe janë shumë të ngarkuar. Në përgjithësi koha e punës shfrytëzohet nga të gjithë punëtorët. Punonjësit janë nën kontrollin e një përgjegjësi si edhe të vetë sipërmarrësit.

k)-Ndarjet e mbetjeve nga punëtorët gjatë shërbimit të grumbullimit të mbetjeve.

Ky process nuk kryhet. Mbetjet pasi merren me kamion shkarkohen tek pika e grumbullimit dhe depozitohen aty. Ndarja e mbetjeve sipas përbërjes së tyre nuk kryhet gjatë punës nga punëtorët, por elementë të saj kryhen veçanërisht me mbetjet inerte. Punonjësit bëjnë kujdes të mos përziejnë mbetjet të tilla si dega peme, bimë të shkultura etj... me materiale si dhera, gurë e materiale të tjera inerte, kur hidhen në vend depozitimitin e mbetjeve inerte. Në datën 28.01.2017 ora 10.30, nga verifikimi në vend-depozitim në orën e shkarkimit të mbetjeve nga mjetet teknologjike, u gjendën rreth 18 persona që punonin aty për të grumbulluar bidona plastikë, qelq, kanaçe alumini etj... Kjo tregon se ndarja e mbetjeve kryhet në mënyrë informale nga individë që sigurojnë të ardhura personale. Nuk ka nisma, inisiativa dhe procese të ndarjes së mbetjeve në burim.

l)- Koha efektive në proceset e punës

Nga bisedat dhe nga vëzhgimet e kryera, vëzhguesit dolën në përfundim se punonjës të njëjtë mbulojnë punë të ndryshme. Duhet theksuar se jo të gjithë punonjësit janë të specializuar dhe të informuar saktë për të gjitha proceset e punës. Në kontakte të drejtpërdrejta

ata janë shprehur se kanë ngarkesë në punë dhe kanë shprehur mendimin se duhet rritur numri i punonjësve për kryrje më të mirë të punës dhe produktivitet më të lartë. Në përgjithësi, gjatë kohës së punës ata i kryenin proceset shumë mirë.

m)- Numri i punonjësve të angazhuar.

Gjatë vëzhgimeve janë vënë re se vetëm 3 grupe të angazhuar në punë. Sipas bisedave me punonjësit është paraqitur kërkesa se ka nevojë për të tjerë punonjës në terren, sepse sipas informacioneve që vëzhguesit kanë marrë ka 29 persona të punësuar ndërkohë që në terren në punën e përditshme janë vënë re një numër më i vogël punonjësish.

Sipërfaqja e territorit në bashkinë e re është shumë më e madhe se më parë por numri i mjeteve dhe pajisjeve është i njëjtë; po ashtu dhe për numrin e punonjësve. Kjo ka sjellë ngarkesë më të madhe për punonjësit.

n)-Pagat së bashku me sigurimet

Pagat janë shumë të ulta rreth 19.000 lek të rinj për person në muaj. Nga bisedat e vëzhguesve me punonjësit ata u shprehën se paga e tyre ishte e ulët në krahasim me punën që ata bënin sepse sasi e grumbullimit dhe hapësira e territorit janë më të mëdha dhe numri i punonjësve është i ulët.

o)- Veshjet me shenjat dalluese.

Sipas vëzhguesve veshjet e punonjësve janë shumë të vjetëruara dhe përdorin të njëjtat veshje si në dimër ashtu edhe në verë. Mungon karta i identifikimit që tregon se individ i punësuar është punonjës pastrimi. Punonjësit janë të pajisur pjesërisht me uniforma dhe mjete dalluese por ato janë të vjetëruara dhe në gjendje jo të mirë që do të thotë se nuk kryejnë ashtu si duhet funksionin që ato kanë.

p)-Ngarkesa e kontrollorëve të punës

Në rastet e vëzhguara, kontrolluesi është parë shumë pak herë në vëndin e punës. Nuk dihet nëse ky fakt vjen për shkak të ngarkesës apo për shkak të mos kryerjes ashtu siç duhet të procesit të punës.

Sipas të dhënave që vëzhguesit morën rezulton se është vetëm një kontrollor për të gjithë zonën që do të thotë se puna nuk mund të kryhet mirë pasi një person i vetëm nuk mund të kontrollojë një zonë kaq të madhe.

q)- Mbajtja e procesverbaleve prej kontrolluesve (supervisorëve)

Edhe pse kontrollori nuk u vëzhgua apo nuk u pati kontakte të shpeshta më atë në terren, në vëzhgimin e dokumentacionit që mbahej prej tij u vërejt se procesverbalet e mbajtura prej tij ishin në regull. Duhet theksuar se asnjë prej vëzhguesve nuk pati kontakt me supervisorin në veprimtarinë e tij në punë në ambient të hapur.



### **Kostoja, standarti dhe proporcionaliteti në financim.**

Me ndarjen e re territoriale objektivat e bashkisë kanë qënë udhërrëfyese për të mundësuar:

- zgjerimin e zonës së shërbimit për heqjen, transportimin dhe përpunimin e vend-grumbullimit, duke gjetur burime të tjera alternative.
- modernizimin e shërbimit të pastrimit, duke synuar rritjen e instrumentave sasiorë dhe cilësisë për kryerjen e këtij shërbimi.
- marrja përsipër dhe realizimi me cilësi më të lartë të palëve të përfshira në proces me fokus rritjen e kënaqshmërisë së qytetarëve për kryerjen e këtij shërbimi.
- zbatimin e parimit ndotësi paguan me objektiva të zvogëlimit të mbetjeve në burim dhe mbulimit të të ardhurave prej tarifës që duhet të paguajnë palët.

Me vendim të Këshillit Bashkiak është përcaktuar buxheti që duhet alokuar për konsumatorët (përfituesit) e këtij shërbimi publik. Falë eksperiencës së gjatë të stafit drejtues të bashkisë në këtë shërbim, është bërë përcaktimi në sasi dhe në % i mbulimit të kostos për familjet, bizneset dhe institucionet. Ky përcaktim është kryer duke ndjekur një politikë të drejtë në shpërndarjen (alokimin) e kostos së shërbimeve publike. Bashkia Kuçovë përfshihet në njësitë e mëdha vendore me më shumë 5000 familje dhe në referencë të kësaj shifre të ardhurat janë parashikuar të realizohen 50% nga familjet, 40% nga bizneset dhe 10% prej institucioneve publike. Të ardhurat për shërbimin janë të parashikuara që të sigurohen nga burimet e mëposhtme për një rritje 3% deri në 5% për çdo vit nëpërmjet:

- rritjes të numrit të subjekteve që duhet të paguajnë tarifë.
- shitjes së produkteve të grumbulluara për riciklim.

Aktualisht bashkia Kuçovë ka një praktikë të mirë në drejtim të llogaritjes së kostove të shërbimit dhe vendosjes së tarifave duke synuar përafrimin e të ardhurave nga tarifa, me kostot për realizimin e shërbimit.

Procesi është realizuar duke u konsultuar me të gjitha palët e interesuara dhe tarifatat janë të publikuara dhe të njohura për qytetarët, bizneset dhe grupet e tjera të tarifë – pagesëve.

**Të ardhura të planifikuara për të realizuar nga tarifatat.**

Drejtimet kryesore të programuara për vitin 2017, për realizimin e të ardhurave, do të jenë:

1. Zgjerimi i bazës së taksueshme
2. Evidentimi, licensimi dhe derdhja e detyrimeve nga të gjithë subjektet që zhvillojnë aktivitetet.
3. Ndjekja në vazhdimësi e arkëtimit të të ardhurave nga debitorët.
4. Arkëtimi i detyrimeve në afatin e përcaktuar në zbatim të ligjeve dhe vendimeve përkatëse.
5. Barazi e plotë për të gjithë taksapaguesit sipas aktivitetit dhe shërbimit që kryhet.

Planifikimi i të ardhurave sipas taksapaguesve paraqitet:


- Ndërmarrjet dhe Institucionet
- Familjet
- Biznesi i madh
- Biznesi i vogël

Më poshtë paraqitet fondi i alokuar për dy vitet e fundit:

1. Buxheti për vitin 2015 me shumën 21,046,000
2. Buxheti prej datës 27.06.2016 deri 27.06.2017 me shumën 32,009,320.

Realizimi i të ardhurave bazohet në miratimin e tarifave sipas vendimit përkatës të Këshillit Bashkiak, të miratuar për paketën fiskale të vitit 2017.

Struktura e realizimit të të ardhurave mbështetet bayuar ne dinamikën e realizimit të të ardhurave në para viteve 2015, si paraqitet në grafikun e mëposhtëm:



Ndërkohë në grafikun e mëposhtëm paraqitet një tabelë me dinamikën në vite që përfshin të dhënat e kostos për realizimin e të ardhurave nga viti 1996 deri në vitin 2015. Bashkia ka bërë përpjekje për një «standart të ri» më të avancuar të shërbimit për të kryer ndarjen e mbetjeve urbane në burim sipas përbërjes së tyre. Ky proces kërkon më shumë fonde për sigurimin e sasisë dhe cilësisë së kontenerëve, për hedhjen e e ndarë të mbetjeve organike (ushqimore), letër, qelq, plastike, metalike etj. si dhe për ndërgjegjësim të qytetarëve që duhet t'i hedhin këto mbetje në vëndet përkatëse. Jep shpresë përpjekja e fundit për zbatimin e një projekti, i cili financohet nga Qeveria Zviceriane, përmes Sekretariat të Shtetit për Çështje Ekonomike- SECO, që ka parashikuar financimin me objektiv Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta në Qarkun e Beratit.



**Kostoja e Sherbimit te Pastrimit dhe pjesa e koston qe mbulohet nga Tarifa e Pastrimit  
per Familjet , Bizneset dhe Institucionet per vitet 1996 – 2015 (000/leke)**

Nr.	Vitet	Kosto e plotë Pastrimit	Pjesa Kost. qe mbulohet B.Bashkise	Tarifa e mbledhur e Pastrimit ne vite, sipas kategorive te perfituesave (ne leke)				Pjesa e Koston qe mbulohet nga Tarifa e Pastrimit (ne %)			
				Totali	Biznese	Familje	Inst+ Nd.	Totali	Biznese	Familje	Inst+ Nd.
1.	1996	5 200	4 329	871	871	-	-	16.7 %	16.7 %	-	-
2.	1997	7 400	6 662	738	738	-	-	10.0 %	10.0 %	-	-
3.	1998	8 006	6 774	1 232	1 232	-	-	15.4 %	15.4%	-	-
4.	1999	8 006	5 732	2 274	1 683	591	-	28.4 %	21.0 %	7.4%	-
5.	2000	10 240	7 015	3 225	2 265	960	-	31.5 %	22.1 %	9.4%	-
6.	2001	12 369	7 447	4 922	3 960	962	-	39.8 %	32.0 %	7.8%	-
7.	2002	12 740	8 162	4 578	3 502	1 076	-	35.9 %	27.5 %	8.4%	-
8.	2003	12 995	7 963	5 032	3 927	1 105	-	38.7%	30.2 %	8.5%	-
9.	2004	13 755	6 791	6 964	5 396	1 310, 2	257, 8	50.6%	39.2%	9.5%	1.9%
10.	2005	14 321	5 852	8 469	5 830	2 029	610	59.2%	40.7%	14.2%	4.3%
11.	2006	15 985	5 874	10 111	6 614, 5	2 014, 5	1 482	63.0%	41.0%	12.7%	9.3%
12.	2007	16 940	6 021	10 919	7 280	1 867	1 772	64.4%	42.9%	11.1%	10.4%
13.	2008	17 448	6 801	10 647	6 938	2 437	1 272	61.0%	39.8%	14.0%	7.2%
14.	2009	18 636	8 477	10 159	6 707	2 289	1 163	54.5%	36.0%	12.3%	6.2%
15.	2010	18 636	12 860	5 776	2 471	2 320	985	30.1%	13.3%	12.5%	5.3%
16.	2011	21 046	16 067	4 979	2 232	1 304	1 443	23.6%	10.6%	6.2%	6.8%
17.	2012	21 046	15 938	5 108	2 379	2 034	695	24.3%	11.3%	9.7%	3.3%
18.	2013	21 046	14 123	6 923	1 971	4 044	908	32.9%	9.4%	19.2%	4.3%
19.	2014	21 046	8 421	12 625	6 453	5 357	815	60%	30.7%	25.4%	3.9%
20.	2015	21 046	8 374	12 672	6 551	5 371	750	60.2%	31.1%	25.5%	3.6%
	<b>Shuma</b>	<b>297 907</b>	<b>169 683</b>	<b>128 224</b>	<b>72 449.5</b>	<b>31 699.7</b>	<b>11 402.8</b>	<b>41.7 %</b>	<b>26.2%</b>	<b>11.5%</b>	<b>4.0%</b>

## KONKLUSIONE :

Bazuar në informacionin e marrë prej administratës së bashkisë, bazuar në vëzhgimin në terren të kryer prej 8 grupeve qytetare si edhe në anketimin e 320 banorëve nga shtresa e grupe të ndryshme shoqërore po radhisim disa konkluzione si më poshtë:

(Pika e parë është hequr)

- Ka diferencim të madh në ofrimin e shërbimit midis zonave në qendër dhe zonave periferike të vendeve të banimit.
- Numri i familjeve dhe sipërfaqja e mbulimit të shërbimit janë rritur më shumë se dy herë, ndërkohë që burimet njerëzore, dhe mjetet e pajisjet teknologjike janë pothuajse të njëjtat. Buxheti i alokuar është rritur 50% krahasuar me periudhën 2011-2016.
- Mjetet dhe pajisjet janë të amortizuara, kanë shumë vite në punë dhe kërkojnë ndërhyrje me kosto të madhe mirëmbajtje. Mjetet kanë nevojë për përmirësim; ato duhet të jenë më të pastra dhe më të rregullta, nuk kanë numra identifikues, nuk janë të lyera dhe nuk kanë simbolet e firmës të cilës i përkasin.
- Gjendja e kontenierëve në zona periferike është e mangët dhe shumë e keqe, pa kapakë e pa rrota. Kontenierët në zonat periferike, atje ku janë vendosur nuk janë të rrethuar me mbrojtëse dhe bëjnë shkak për aksidente.
- Mjetet e punës dhe pajisjet ndihmëse egzistojnë por nuk janë në gjëndje të mirë pune pasi kanë shumë kohë në përdorim.
- Në pjesë të caktuara të territorit të bashkisë Kuçovë shërbimi me mjete dhe pajisje, është i pakët ose pothuajse inegzistent dhe rrjedhimisht nuk realizohet mbulimi i shërbimit për të gjithë qytetarët, bazuar në informacion të marë prej drejtuesve të bashkisë, përgjegjës për këtë shërbim.
- Punonjësit njohin mirë proceset e punës por duhet të njohin më shumë të drejtat dhe detyrat e tyre.
- Punonjësit bëjnë punë të mbingarkuar dhe një pjesë e mirë e tyre janë shprehur që lodhen shumë dhe janë shumë të ngarkuar.
- Punonjësit nuk janë të mirënjohur me rreziqet e aksidenteve në punë dhe rastet mund të ndodhin nga dita në ditë dhe kjo vjen si prej neglizhencës së punonjësve ashtu edhe prej mjeteve dhe pajisjeve të amortizuara.
- Mungon karta i identifikimit që tregon se individ i punësuar është punonjës pastrimi.
- Në bashkinë Kuçovë aktualisht nuk ka sasi të mbetjeve urbane që ndahen e shkojnë për kompostim, një proces që ka egzistuar më parë. Ndërhyrja në vend-grumbullimin e mbetjeve në Rreth Tapi është emergjente.
- Mbetjet e grumbulluar depozitohen shumë afër rrjedhjes së lumit, 50 deri në 100 metra larg masës së grumbullimit të mbetjeve pranë lumit Devoll dhe rrjedhjet përbëjnë rrezik të përhapin sëmundje brenda edhe jashtë territorit të bashkisë.
- Pika e grumbullimit është e hapur dhe shkakton ndotje në tokë dhe në ajër; rrjedhjet prej mbetjeve të kompostuara prej vitesh shkojnë në lumin Seman si dhe përfundojnë në det. Situata është alarmante.